



Terms of Reference (ToR)

Angazhimi i studenteve për shërbimdhënie në Konferencën Rajonale për Fuqizimin e Grave Rurale në Ballkanin Perëndimor

1. Konteksti

EcoKosWomen (EKW) fton studentet e interesuara të angazhohen për asistim teknik të Konferencës Rajonale për Fuqizimin e Grave Rurale në Ballkanin Perëndimor, e cila organizohet më 16 shtator 2025, në ambientet e Hotelit Emerald, Prishtinë, në kuadër të projektit “Fuqizimi i grave dhe komuniteteve që jetojnë në viset rurale të Kosovë”, i mbështetur financiarisht nga We Effect, Suedia.

Konferenca synon të ofrojë një hapësirë gjithëpërfshirëse për diskutim mbi sfidat dhe mundësitë në fushën e fuqizimit social dhe ekonomik të grave rurale në rajon. Ngjarja do të mbledhë përfaqësues të institucioneve qeveritare, organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile dhe lidere të komuniteteve rurale, me qëllim të shkëmbimit të përvojave, praktikave të mira dhe ndërtimit të partneriteteve të reja.

Studentet do të marrin pjesë në organizimin praktik të konferencës dhe do të fitojnë përvojë praktike në një ngjarje rajonale.

3. Qëllimi i angazhimit

Angazhimi i studenteve ka për qëllim të sigurojë mbështetje praktike dhe efikase për organizimin dhe zhvillimin e Konferencës Rajonale, përmes asistencës logjistike dhe komunikative gjatë gjithë kohëzgjatjes së ngjarjes.

4. Detyrat kryesore të vullnetarëve

- Parapërgatitje për mbarëvajtjen e konferencës;
- Asistencë gjatë regjistrimit të pjesëmarrësve;
- Mbështetje logjistike gjatë konferencës si në shpërndarje materialesh dhe koordinim me stafin e organizatës dhe pjesëmarrësit, duke përfshirë edhe kërkesa të tjera nga ana e organizatorëve;
- Orientimi i pjesëmarrësve dhe ofrimi i informacioneve praktike; si dhe
- Ofrimin e shërbimeve të tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e konferencës;
- Pjesëmarrja në punëtorinë e Platformës Rajonale;



5. Kohëzgjatja e angazhimit

Shërbimi do të ofrohet për kohë të caktuar dhe atë nga data 15 shtator 2025 deri më datën 17 shtator 2025.

6. Kriteret e përzgjedhjes

Studentët duhet të përmbushin këto kriteret:

1. Njohja e shkëlqyer e gjuhës angleze;
2. Të jenë studentë të nivelit Bachelor ose Master;
3. Aftësi të shkëlqyera komunikuese dhe ndërpersonale;
4. Përvojë paraprake si praktikante ose pjesëmarrje në ngjarje akademike/konferenca është përparësi;
5. Aftësi të mira organizative dhe orientim ndaj detajeve;
6. Fleksibilitet dhe gatishmëri për të punuar nën presion dhe në ekip;
7. Mirësjellje, profesionalizëm dhe motivim i lartë për të kontribuar.

7. Dokumentet që duhet të dorëzohen

Studentet e interesuara duhet të dorëzojnë:

1. CV të përditësuar;
2. Letër motivimi;

8. Afati i aplikimit

- Afati i fundit për aplikim është: **15 shtator 2025, ora 10:00 (CET).**
- Dokumentet duhet të dorëzohen me e-mail në adresën: ecokoswomen1@gmail.com;